| <p>1.9. Terrorist - ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>1.10. Grup terrorist - ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>1.11. Përhapja – nënkupton aktivitetet e çdo pale jo shtetërore për prodhimin, blerjen, posedimin, zhvillimin, transportimin, transferimin ose përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike dhe mjeteve të tyre të lëshimit, veçanërisht për qëllime terroriste, si dhe përpjekjet për t’u angazhuar në cilindo nga aktivitetet e mësipërme, pjesëmarrja në to si bashkëpunëtor, ndihmës ose financues.</p> <p>1.12. Veprim terrorist - ka kuptimin e njëjtë si në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>1.13. Bordi – nënkupton për qëllime të këtij ligji, Bordin Mbikëqyrës të Njësisë për Inteligjencë Financiare të themeluar sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, duke përfshirë edhe një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Punë të Jashtme dhe një nga Ministria përgjegjëse për Tregti dhe Industri nga fusha për tregti me mallra strategjike.</p> <p>1.14. Person raportues - nënkupton</p> | <p>1.9. Terrorist - means the same as defined in the Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>1.10. Terrorist group – means the same as defined in the Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>1.11. Proliferation – refers to the activities of any non-state party to manufacture, acquire, possess, develop, transport, transfer or use nuclear, chemical or biological weapons and their means of delivery, in particular for terrorist purposes, as well as the attempts to engage in any of the above activities, participation in them as as an accomplice, supporter or financier.</p> <p>1.12. Terrorist act – means the same as defined in the Criminal Code of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.13. Board – for the purpose of this Law, means the Oversight Board of the Financial Intelligence Unit established based on the Law on Prevention of Money Laundering and Combating Terrorist Financing, including one representative from the competent Ministry of Foreign Affairs and one representative from the competent Ministry of Trade and Industry from the field of strategic goods trade.</p> <p>1.14. Reporting person - means natural and</p> | <p>1.9. Terorista - ima isto značenje kao u Krivičnog zakoniku Kosova.</p> <p>1.10. Teroristička grupa - ima isto značenje kao u Krivičnog zakoniku Kosova.</p> <p>1.11. Širenje – podrazumeva aktivnosti bilo koje nedržavne strane za proizvodnju, nabavku, posedovanje, razvoj, transport, transfer ili upotrebu nuklearnog, hemijskog ili biološkog oružja i njenih sredstava za ispuštanje, posebno za terorističke svrhe, kao i pokušaji za angazovanje u bilo koju od gore navedenih aktivnosti, učešće u njima kao saradnik, pomoćnik ili finansijer.</p> <p>1.12. Teroristički akt – ima isto značenje kao u Krivičnog zakoniku Kosov.</p> <p>1.13. Odbor - podrazumeva, za svrhe ovog zakona, Nadzorni odbor Jedinice finansijske inteligencije osnovan prema Zakonu o sprečavanju pranja novca i borbe protiv finansiranja terorizma, uključujući jednog predstavnika iz Ministarstva inostranih poslova i jednog iz Ministarstva nadležne za trgovinu i industriju iz oblasti trgovine strateškom robom.</p> <p>1.14. Izvestilac - podrazumeva fizička i</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>personin fizik ose juridik, si dhe subjektet raportuese të përkufizuara sipas ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.</p> <p>1.15. Sanksione financiare të shënjestruara - nënkuptojnë ngrirjen dhe bllokimin e fondeve ose pasurive tjera, me qëllim parandalimin që të njëjtat të vihen në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të mirën e personave dhe entiteteve të përcaktuara.</p> <p>1.16. Pa vonesë/menjëherë - nënkupton detyrimin për të ndërmarrë veprime dhe/apo ngrirë fondet ose pasuritë e tjera të personave dhe entiteteve të përcaktuara në periudhën më të shkurtër kohore, idealisht brenda disa orëve nga një përcaktim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo komiteteve relevante, si dhe për qëllime të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nënkupton që sapo të ketë dyshim të arsyeshëm për të besuar se një person ose entitet është terrorist, është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit; financimin e terrorizmit; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i përfshirë në përhapjen.</p> <p>1.17. Sekuestrimi - është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të ndërlihdura, pjesëmarrjeje në</p> | <p>legal persons, and reporting entities defined according to the relevant Law on Prevention of Money Laundry and Combating Terrorist Financing.</p> <p>1.15. Targeted financial sanctions - means both asset freezing and prohibitions to prevent funds or other assets from being made available, directly or indirectly, for the benefit of designated persons and entities.</p> <p>1.16. Without delay/immediately - means the obligation to take action and/or freeze the funds or other assets of designated persons and entities in the shortest period of time, ideally within a few hours of a designation by the United Nations Security Council or relevant committees, and for purposes of United Nations Security Council Resolution 1373 (2001), means that as soon as there is reasonable doubt to believe that a person or entity is a terrorist, is or has been involved in terrorist activities; terrorist financing; involved in the activities of a terrorist group or in committing a terrorist act or is involved in proliferation.</p> <p>1.17. Seizure - is the prohibition of any transaction, financial or other related services, participation in transferring,</p> | <p>pravna lica, kao i izveštajne subjekte definisane Zakonom o sprečavanju pranja novca i borbe protiv finansiranja terorizma.</p> <p>1.15. Ciljane finansijske sankcije - podrazumeva zamrzavanje i blokiranje fondova ili imovine kako bi se sprečilo da se isti budu stavljeni na raspolaganju, neposredno ili posredno, u korist označenih lica ili entiteta.</p> <p>1.16. Bez odlaganja/odmah – podrazumeva obavezu preduzimanja radnji i/ili zamrzavanja fondova ili druge imovine označenih lica ili entiteta u najkraćem vremenskom periodu, u idealnom slučaju, u roku od nekoliko sati od označavanja Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija ili relevantnih komiteta, kao i za potrebe Rezolucije 1373 (2001) Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija, znači da u trenutku postojanja opravdane sumnje koja dovodi do verovanja da je jedno lice ili entitet terorista, jeste ili je bio uključen u terorističkim aktivnostima; finansiranje terorizma; uključen u aktivnostima jedne terorističke grupe ili izvršenju terorističkog akta ili je uključen u širenju.</p> <p>1.17. Zaplena - je zabrana svake transakcije, finansijske ili druge povezane usluge, učešće u transferu, transformaciji, otuđivanju ili</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së sekuestrimit.</p> <p>1.18. Blokim i përkohshëm - është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të ndërlidhura, pjesëmarrje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve e të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së bllokimit të përkohshëm.</p> <p>1.19. Fonde - janë pasuri të çdo lloji, qofshin këto materiale ose jomateriale, të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht se si janë fituar, si dhe dokumente apo instrumente ligjore të çdo forme, duke përfshirë ato elektronike apo digjitale, të cilat dëshmojnë të drejtën apo interesat në këto pasuri.</p> <p>1.20. Lista e përcaktimeve - i referohet</p> | <p>alteration, alienation or displacement of funds and other properties, movable or immovable, according to the terms and the validity of actions undertaken by the relevant authorities, in conformity with this law. Funds and other properties siezed remain under the ownership of the persons that have property rights over them at the moment of the imposition of the seizing measure.</p> <p>1.18. Temporary blocking - is the prohibition of any transaction, financial service or others related to that, participation in transferring, alteration, alienation or displacement of funds and other properties, on movable or immovable properties, according to the terms and the validity of actions undertaken by the relevant authorities, in conformity with this law. Funds and other properties blocked temporarily remain under the ownership of the persons that have property rights over them at the moment of the imposition of the measure for the temporary blocking.</p> <p>1.19. Funds - refers to assets of every kind, whether material or immaterial, tangible or intangible, movable or immovable, regardless how they were acquired, and legal documents or instruments in any form, including electronic or digital ones, evidencing entitlement to, or interest in, such assets.</p> <p>1.20. Designation lists - refers to the lists of</p> | <p>premeštanjju fondova i druge imovine, za pokretnu ili nepokretnu imovinu, prema uslovima i trajanju validnosti radnji preduzetih od strane odgovarajućih organa, u skladu sa ovim zakonom. Zapljenjeni fondovi ili imovina ostaju u vlasništvu lica koja imaju svojinsko pravo nad njima u nametanja mere zaplene.</p> <p>1.18. Privremena blokada - je zabrana svake transakcije, finansijske ili povezane usluge, učešće u transferu, transformaciji, otuđivanju ili premeštanjju fondova i druge imovine, za pokretnu ili nepokretnu imovinu, prema uslovima i trajanju validnosti radnji preduzetih od strane odgovarajućih organa, u skladu sa ovim zakonom. Fondovi i ostala imovina, privremeno blokirana, ostaju u vlasništvu lica koja imaju svojinsko pravo nad njima u trenutku nametanja mere privremene blokade.</p> <p>1.19. Fondovi - su imovina bilo koje vrste, bilo da je materijalna ili nematerijalna, opipljiva ili neopipljiva, pokretna ili nepokretna, bez obzira kako je stečena, kao i dokumenta ili pravni instrumenti bilo kojeg oblika, uključujući one elektronske ili digitalne, koji dokazuju pravo ili interese u ovoj imovini.</p> <p>1.20. Lista označavanja - odnosi se na liste</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>listave të personave ose entiteteve të përcaktuara të publikuara nga ose në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara në kontekstin e luftimit të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit (listat e përcaktimit të lidhura me terrorizmin) dhe/ose përhapjen dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë (listat e përcaktimit në lidhje me përhapjen).</p> <p>1.21. Entitet - është një subjekt i ndryshëm nga shteti, personi fizik dhe juridik, i huaj ose vendas, ndaj të cilit vendoset masa për ngrirjen e fondeve dhe pasurive tjera, sipas përcaktimeve të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe sipas këtij ligji.</p> <p>1.22. Marrëveshjet juridike - truste dhe marrëveshje të tjera juridike të ngjashme.</p> <p>KAPITULLI II LISTA E PERSONAVE TË PËRCAKTUAR DHE PROCEDURAT E PËRCAKTIMIT</p> <p>Neni 4 Sanksionet ndërkombëtare ndaj personave të përcaktuar sipas Listave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara</p> <p>1. Zbatimi i Sanksioneve Financiare të</p> | <p>designated persons or entities published by or in accordance with the United Nations Security Council resolutions for the application of targeted financial sanctions in the context of combating terrorism and terrorist financing (also referred to as terrorism-related designation lists) and/or proliferation of weapons of mass destruction and its financing (also referred to as proliferation-related designation lists).</p> <p>1.21. Entity - is an entity other than the state, natural and legal person, foreign or national, against which measures are taken to freeze funds and other assets, as defined by United Nations Security Council Resolutions, as well as according to this law.</p> <p>1.22. Legal agreements – trusts and other similar legal agreements.</p> <p>CHAPTER II LIST OF DESIGNATED PERSONS AND DESIGNATION PROCEDURES</p> <p>Article 4 International Sanctions against Designated Persons according to the Lists of the United Nations Security Council</p> <p>1. The implementation of Targeted Financial</p> | <p>označenih lica ili entiteta koje su objavljene od ili u skladu sa rezolucijama Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija za sprovođenje ciljanih finansijskih sankcija u pogledu borbe protiv terorizma i finansiranja terorizma (liste označavanja vezana za terorizam) i/ili širenje i finansiranja oružja za masovno uništenje (liste označavanja vezana sa širenjem).</p> <p>1.21. Entitet - je subjekat različit od države, fizičkog i pravnog lica, stranog ili domaćeg, prema kome se namećuje mera za zamrzavanje fondova i ostalih imovina, u skladu sa označavanjima rezolucija Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija, kao i pram ovom zakonu.</p> <p>1.22. Pravni sporazumi – trustovi i drugi slični pravni sporazumi.</p> <p>POGLAVLJE II LISTA OZNAČENIH LICA I PROCEDURA OZNAČAVANJA</p> <p>Član 4 Međunarodne sankcije protiv označenih lica prema Listama Saveta bezbednosti Ujedinjenih nacija</p> <p>1. Sprovođenje ciljanih finansijskih sankcija</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>Shënjestruara bëhet sipas dispozitave të nenit 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare.</p> <p>2. Lista e konsoliduar e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në gjuhën angleze dhe çdo amendamentim pasues do të publikohet në ueb faqen e Njesisë për Inteligjencë Financiare (tutje: NjIF-K) pa vonesë, dhe kanë fuqi të drejtpërdrejt dhe menjëhershme.</p> <p>3. Për çfarëdo ndryshimi të bërë në listë sipas paragrafit 1 të këtij neni, NjIF-K njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për financa, ministrinë përgjegjëse për punë të brendshme, ministrinë përgjegjëse për punë të jashtme, ministrinë përgjegjëse për tregti dhe industri, Doganën e Kosovës, Administratën Tatimore, Prokurorinë e Shtetit, Bankën Qendrore të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, subjektet raportuese dhe institucionet tjera të cilat vlerësohet e nevojshme të informohen.</p> <p>4. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme përmes aktit nënligjor përcakton mënyrën e zbatimit të këtij neni.</p> | <p>Sanctions shall take place in accordance with Articles 3 and 5 of the Law No. 03/L-183 on the Implementation of International Sanctions.</p> <p>2. The consolidated list of sanctions of the United Nations Security Council in the English language and any following amendments shall be published in the webpage of the Financial Intelligence Unit of Kosovo hereinafter referred as FIU-K, without delay and have direct and immediate effect.</p> <p>3. For any change made in the list according to paragraph 1 of this article, the FIU-K immediately notifies the ministry responsible for finance, the ministry responsible for internal affairs, the ministry responsible for foreign affairs, the ministry responsible for trade and industry, Kosovo Customs, Administration Tax Office, State Prosecutor's Office, Central Bank of Kosovo, Kosovo Intelligence Agency, Business Registration Agency, reporting entities and other institutions which it deems necessary to be informed.</p> <p>4. The competent Ministry for Foreign Affairs shall determine the manner of application of this article through a sub-legal act.</p> | <p>vrši se prema članu 3. i 5. Zakona br. 03/L-183 o sprovođenju međunarodnih sankcija.</p> <p>2. Konsolidovana lista sankcija Saveta bezbednosti Organizacije ujedinjenih nacija na engleskom jeziku i sve naknadne izmene i dopune biće objavljene na internet stranici Jedinice finansijske inteligencije (u daljem tekstu JFI-K) bez kašnjenja, i imaju neposrednu i trenutnu primenu.</p> <p>3. Za svaku izmenu izvršenoj na listi iz stava 1. ovog člana, JFI-K, odmah obaveštava ministarstvo nadležno za finansije, ministarstvo nadležno za unutrašnje poslove, ministarstvo nadležno za inostrane poslove, ministarstvo nadležno za trgovinu i industriju, Carinu Kosova, Poresku administraciju, Državno tužilaštvo, Centralnu banku Kosova, Kosovsku obaveštajnu agenciju, Agenciju za registraciju biznisa, izveštajne subjekte i druge institucije koje se smatra da je potrebno da budu informisane.</p> <p>4. Ministarstvo nadležno za inostrane poslove putem podzakonskog akta određuje način sprovođenja ovog člana.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p style="text-align: center;">Propozimet e autoriteteve shtetërore për përcaktimin e personave në listën vendore</p> <p>1. Ministria përgjegjëse për punë të brendshme, ministria përgjegjëse për punë të</p> | <p style="text-align: center;">Article 5</p> <p style="text-align: center;">Proposals of state authorities for designation of persons in the national list</p> <p>1. The ministry responsible for internal affairs, the ministry responsible for foreign affairs, the</p> | <p style="text-align: center;">Član 5</p> <p style="text-align: center;">Predlozi državnih organa za označavanje lica na domaćoj listi</p> <p>1. Ministarstvo nadležno za unutrašnje poslove, ministarstvo nadležno za inostrane</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>jashtme, ministria përgjegjëse për tregti dhe industri, Prokuroria e Shtetit, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, NjIF-K, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore si dhe institucionet e tjera, të cilat në kuadër të fushëveprimit të tyre janë vënë në dijeni ose kanë arsye për të besuar për përfshirjen e personit fizik apo juridik në çfarëdo forme, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet personave të tjerë, në veprimet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, janë të detyruar të dorëzojnë propozimin për përcaktim tek ministri përgjegjës për financa, dhe të propozojnë marrjen e masave në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p> | <p>ministry responsible for trade and industry, State Prosecutor's Office, Kosovo Intelligence Agency, FIU-K, Kosovo Customs, Tax Administration and other institutions, which within their scope are informed or have reason to believe in the involvement of a natural or legal person in any form, directly or through other persons, in the actions provided for in paragraph 2 of this article, are obliged to submit the proposal for designation to the minister responsible for finance, and propose taking measures in accordance with the provisions of this law.</p> | <p>poslove, ministarstvo nadležno za trgovinu i industriju, Državno tužilaštvo, Kosovska obaveštajna agencija, JFI-K, Carina Kosova, Poreska administracija, kao i druge institucije koje u okviru svog delokruga, su upoznate ili imaju razloga da veruju o uključivanju fizičkog ili pravnog lica u bilo kom obliku, bilo da je to neposredno ili preko drugih lica, u radnjama predviđenim u stavu 2. ovog člana, dužni su da podnose predlog za označavanje, kod ministra nadležnog za finansije i da predlože preduzimanje mera u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> |
| <p>2. Propozimi për përcaktim siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajë të gjitha informatat relevante që tregojnë arsyet për të besuar se një person është terrorist, është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimit të terrorizmit, i përfshirë në aktivitete të një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i ndërlidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.</p> | <p>2. The proposal for designation as set forth in paragraph 1 of this Article shall contain the entire relevant information indicating the reasons to believe that a person is a terrorist, he/she is or was involved in terrorist activities, financing of terrorism, involved in activities of a terrorist group or in committing a terrorist act or is associated with proliferation of weapons of mass destruction.</p> | <p>2. Predlog o označavanju kao što je predviđeno stavom 1. ovog člana treba da sadrži sve relevantne informacije koje ukazuju na razloge za verovanje da je lice terorista, jeste ili je bio uključen u terorističkim aktivnostima; finansiranje terorizma; uključen u aktivnosti terorističke grupe ili u izvršenju terorističkog akta ili je povezano sa širenjem oružja za masovno uništenje.</p> |
| <p>3. Propozimi sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë informata të detajuara në lidhje me asetet që mund të jenë subjekt i ngrirjes, dhe i njëjti duhet të bëhet menjëherë dhe pa vonesë.</p> | <p>3. The proposal according to paragraph 1 of this article must contain detailed information regarding the assets that may be subject to freezing, and the same must be done immediately and without delay.</p> | <p>3. Predlog iz stava 1. ovog člana treba da sadrži detaljne podatke o imovini koja može biti predmet zamrzavanja, i isti treba izvršiti odmah bez odlaganja.</p> |
| <p>4. Për shqyrtimin e propozimit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, ministri përgjegjës për financat mund të thërrasë Bordin si një komitet</p> | <p>4. For the review of the proposal according to paragraphs 1 and 2 of this article, the minister responsible for finance may convene the Board</p> | <p>4. Za razmatranje predloga iz st. 1. i 2. ovog člana, ministar nadležan za finansije može sazvati Odbor kao poseban savetodavni</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>të posaçëm këshillimor që të mbildhet pa vonesë nga pranimit i propozimit.</p> <p>5. Ministri përgjegjës për financat, pa vonesë, i propozon Qeverisë për përcaktimin e personave në listën vendore dhe marrjen e masave të parashikuara me këtë ligj.</p> <p>6. Procedura lidhur me paraqitjen e propozimeve nga autoritetet shtetërore për përcaktimin e personave në listën vendore rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga ministria përgjegjëse për financa dhe të aprovuar nga Qeveria.</p> | <p>as a special advisory committee to be convened without delay from the acceptance of the proposal.</p> <p>5. The Minister responsible for finance, without delay, proposes to the Government to designate the persons in the local list and to take the measures provided by this law.</p> <p>6. The procedure regarding the submission of proposals by the state authorities for the designation of persons in the local list is regulated by a sub-legal act proposed by the ministry responsible for finance and approved by the Government.</p> | <p>komitet koji se sastaje bez odlaganja od prijema predloga.</p> <p>5. Ministar nadležan za finansije, bez odlaganja, predlaže Vladi da označava lica na domaćoj listi i preduzimanje mera predviđenih ovim zakonom.</p> <p>6. Procedura u vezi sa podnošenjem predloga od strane državnih vlasti za označavanje lica na domaćoj listi uređuje se podzakonskim aktom koji predlaže ministarstvo nadležno za finansije, a koji usvaja Vlada.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 6 Vendimi për listim të personave të përcaktuar në listën vendore</p> <p>1. Qeveria pa vonesë merr vendim për përfshirjen në listën vendore të personave dhe entiteteve të përcaktuara në bazë të:</p> <p>1.1. Propozimit për përcaktim të bërë sipas nenit 5, paragrafi 5 të këtij ligji, bazuar në dyshimin e arsyeshëm se një person i tillë është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimin e terrorizmit, ; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist ose është i ndërlidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.</p> <p>1.2. Kërkesës së pranuar nga një shtet i huaj sipas nenit 9 të këtij ligji.</p> | <p style="text-align: center;">Article 6 Decision on listing designated persons in the local list</p> <p>1. The Government shall decide, without any delay, on inclusion of designated persons and entities to the local list, based on:</p> <p>1.1. The proposal for designation made according to article 5, paragraph 5 of this law, based on reasonable suspicion that such a person is or has been involved in terrorist activities, terrorist financing, involved in the activities of a terrorist group or in the commission of a terrorist act or is linked to the proliferation of weapons of mass destruction.</p> <p>1.2. The request received from a foreign country, in accordance with Article 9 of</p> | <p style="text-align: center;">Član 6 Odluka za listiranje označenih lica u domaćoj listi</p> <p>1. Vlada bez odlaganja donosi odluku da se u domaću listu uključe označena lica i entiteti na osnovu:</p> <p>1.1. Predloga za označavanje izvršenog prema stavu 5. člana 5. na osnovu opravdane sumnje da takvo lice jeste ili je bilo uključeno u terorističke aktivnosti; finansiranje terorizma; uključeno u aktivnostima terorističke grupe ili u izvršenju terorističkog akta ili je povezano sa širenjem oružja za masovno uništenje.</p> <p>1.2. Dostavljenom zahtevu od jedne strane države, prema članu 9. ovog Zakona.</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>2. Qeveria merr vendim bazuar në dyshimin e arsyeshëm, pavarësisht nëse është duke u zhvilluar një hetim në lidhje me subjektin e propozuar.</p> <p>3. Vendimi për listim duhet të përmbajë:</p> <p>3.1. detajet e plota të personit të përcaktuar, përfshirë arsyen e përfshirjes;</p> <p>3.2. detajet e plota të aseteve që duhen ngrirë;</p> <p>3.3. njoftimin e organeve kompetente për ekzekutimin e vendimeve sipas ligjit;</p> <p>3.4. listën e personave të cilëve duhet dorëzuar vendimi.</p> <p>4. Për çdo ndryshim në listën e personave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, NjIF-K njofton pa vonesë subjektet raportuese që janë të detyruar të zbatojnë veprimet dhe masat për parandalimin e financimit të terrorizmit dhe për përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.</p> <p>5. Me kërkesën e ministrit përgjegjës për financa, Qeveria shqyrton arsyeshmërinë e përcaktimeve së paku një (1) herë në vit.</p> | <p>this law.</p> <p>2. The Government shall take a decision based on the reasonable suspicion, regardless of whether investigations regarding the proposed entity are being conducted.</p> <p>3. The decision on listing shall contain:</p> <p>3.1. full details of the designated person, including reason for inclusion;</p> <p>3.2. full details of the assets to be frozen;</p> <p>3.3. informing bodies competent for execution of the decisions, according to the Law;</p> <p>3.4. list of persons to be served with the decision.</p> <p>4. The FIU-K shall notify, without any delay, the reporting entities that are obliged to apply actions and measures for prevention of terrorist financing and proliferation of weapons of mass destruction, about any changes to the list of persons designated under paragraph 1 of this Article.</p> <p>5. At the request of the Minister responsible for finance, the Government reviews the reasonableness of the designations at least once (1) a year.</p> | <p>2. Vlada donosi odluku na osnovu opravdane sumnje, bez obzira da li je u toku istraga u vezi sa predloženim subjektom.</p> <p>3. Odluka o listiranju treba da sadrži:</p> <p>3.1. potpune detalje označenog lica, uključujući razlog uključivanja;</p> <p>3.2. potpune detalje imovine koju treba zamrznuti;</p> <p>3.3. obaveštavanje nadležnih organa o izvršenju odluka prema zakonu;</p> <p>3.4. listu lica kojima se odluka treba dostaviti.</p> <p>4. JFI-K će bez odlaganja obavestiti subjekte izveštavanja koji su obavezni da sprovedu radnje i mere za sprečavanje finansiranja terorizma i širenja oružja za masovno uništenje, o svakoj izmeni u listi označenih osoba iz stava 1. ovog člana.</p> <p>5. Vlada će, na zahtev ministra nadležnog za finansije, najmanje jednom (1) godišnje, razmotriti opravdanost označavanja.</p> |
|--|--|---|

| <p style="text-align: center;">Neni 7</p> <p style="text-align: center;">Propozimi për përfshirjen e personit të përcaktuar në listën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara</p> | <p style="text-align: center;">Article 7</p> <p style="text-align: center;">Proposal for inclusion of the designated person to the list of the United Nations Security Council</p> | <p style="text-align: center;">Član 7</p> <p style="text-align: center;">Predlog za uključivanje označenog lica u listu Saveta bezbednosti Organizacije ujedinjenih nacija</p> |
|--|--|--|
| <p>1. Qeveria, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i propozon Komitetit të Këshillit të Sigurimit 1267/1989 dhe Komitetit të Këshillit të Sigurimit 1988 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që një person të përfshihet në listën e personave të përcaktuar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nëse:</p> <p>1.1. personi i cili është përfshirë në listën vendore të personave të përcaktuar nga Qeveria, është i ndërlidhur me personat ose organizatat e përcaktuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;</p> <p>1.2. personi nuk është në listën e personave të përcaktuar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.</p> <p>2. Propozimi për përcaktim sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban informatat relevante të cilat identifikojnë qartë subjektin e propozimit, dhe të cilat mbështeten në arsyen për të dyshuar se personi është apo ka qenë i përfshirë në aktivitete të terrorizmit, financimin e terrorizmit; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist, ose është i lidhur me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.</p> <p>3. Propozimi sipas paragrafit 1 të këtij neni</p> | <p>1. The Government may propose, through diplomatic channels, to the Committee of the Security Council 1267/1989 and the Committee of the Security Council 1988 of the United Nations to include a person in the list of designated persons of the United Nations Security Council, if:</p> <p>1.1. The person, who has been included in the list of persons designated by the Government, is related to persons or organizations designated by the Resolutions of the United Nations Security Council;</p> <p>1.2. The person is not in the list of persons designated by the United Nations Security Council.</p> <p>2. The proposal for designation as required by the paragraph 1 of this Article shall contain relevant information clearly identifying the subject of proposal and supporting the reason for suspecting that the person is or was involved in terrorist activities; terrorist financing; involved in activities of a terrorist group or committing a terrorist act or is associated with proliferation of weapons of mass destruction.</p> <p>3. The proposal shall, according to paragraph 1</p> | <p>1. Vlada, preko diplomatskih kanala, predlaže Komitetu Saveta bezbednosti 1267/1989 i Komitetu Saveta bezbednosti 1988 Organizacije ujedinjenih nacija da jedno lice bude uključeno na listu označenih lica Saveta bezbednosti Organizacije ujedinjenih nacija, ako:</p> <p>1.1. lice koje je uključeno u domaću listu lica označenih od strane Vlade, povezano je sa licima ili organizacijama označenim u rezolucijama Saveta bezbednosti Organizacije Ujedinjenih nacija;</p> <p>1.2. lice nije na listi označenih lica Saveta bezbednosti Organizacije Ujedinjenih nacija.</p> <p>2. Predlog za označavanje, iz stava 1. ovog člana, sadrži relevantne informacije koje jasno identifikuju predmet predloga i koji se zasnivaju na razlogu za sumnju da lice jeste ili je bilo uključeno u terorističke aktivnosti, finansiranje terorizma; uključeno u aktivnosti terorističke grupe ili u izvršenje terorističkog akta, ili je povezan sa širenjem oružja za masovno uništenje.</p> <p>3. Predlog iz stava 1. ovog člana sadrži</p> |

përmban informata të detajuara lidhur me pasuritë që mund të jenë subjekt i urdhrat për ngrirje dhe informacione të tjera siç kërkohet me standardet përkatëse të komiteteve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe aty ku është e mundur, propozimi duhet të dorëzohet duke përdorur format standarde të miratuara nga këto Komitete.

4. Nëse bëhet propozimi për përcaktim sipas paragrafit 1 të këtij neni, në propozim duhet të specifikohet që Republika e Kosovës mund të prezantohet publikisht nga Kombet e Bashkuara si shtet i cili është kompetent të propozojë persona për përcaktim, si dhe të definojë qartë se cilat pjesë të propozimit dhe informacioneve plotësuese duhet të trajtohen si konfidenciale dhe që nuk vihen publikisht në dispozicion pa marrëveshje me shkrim me Qeverinë.

Neni 8

Parashtrimi i kërkesës shtetit të huaj

1. Nëpërmjet kanaleve diplomatike, ministria përgjegjëse për punë të jashtme dërgon kërkesën drejtuar shtetit të huaj për të ngrirë pasuritë e personit të përcaktuar sipas vendimit të Qeverisë, nëse ka dyshime se personi i përcaktuar ka asete në atë shtet.

2. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat përkatëse të personit, të cilat vërtetojnë dyshimin e arsyeshëm se personi është ose ka

of this Article, contain detailed information regarding the assets that may be subject to the freezing order and other information as requested by relevant standards of the Committees of the United Nations Security Council, and where possible, the proposal shall be submitted using standard forms adopted by these Committees.

4. If there is a proposal for designation according to paragraph 1 of this Article, it should be specified that Republic of Kosovo can be publicly presented by the United Nations as a country eligible to propose persons for designation, and there shall be clearly determined which parts of the proposal and additional information are to be handled as confidential and they shall not be made publically available without a written agreement with the Government.

Article 8

Filing of a request to a foreign country

1. The ministry responsible for foreign affairs, through diplomatic channels, shall send the request to a foreign country in order to freeze the assets of the designated persons in accordance with the decision of the Government, if there are suspicions that the designated person has assets in that country.

2. The request shall contain relevant data of the person, the data proving the reasonable suspicion that the person is or was involved in

detaljne informacione u vezi sa imovinama koja mogu biti predmet naloga za zamrzavanje i druge informacije kako se to zahteva odgovarajućim standardima komiteta Saveta bezbednosti Organizacije Ujedinjenih nacija, i gde je moguće, predlog treba biti podnesen primenom standardnih obrazaca usvojenih od strane ovih Komiteta.

4. Ako se izradi predlog za označavanje iz stava 1. ovog člana, u predlogu treba da se navodi da Republika Kosovo može biti javno predstavljeno od strane Ujedinjenih nacija kao država koja je nadležna da predloži lica za označavanje, kao i da jasno definiše koji delovi predloga i dodatnih informacija treba da budu tretirane kao poverljive i koje ne smeju da budu dostupne javnosti bez pismenog sporazuma sa Vladom.

Član 8

Podnošenje zahteva stranoj državi

1. Ministarstvo nadležno za inostrane poslove će, preko diplomatskih kanala, dostaviti zahtev stranoj državi da zamrzne imovinu označenog lica shodno odluci Vlade, ako postoji sumnja da označeno lice ima imovinu u toj državi.

2. Zahtev treba da sadrži relevantne podatke lica, koji potvrđuju osnovanu sumnju da lice jeste ili je bilo angažovano u aktivnostima koje

| | | |
|---|--|---|
| <p>qenë i angazhuar në aktivitete që përfshijnë terrorizmin; financim të terrorizmit, i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist apo ka lidhje me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Propozimi po ashtu duhet të përmbajë informata të detajuara lidhur me asetet që mund të jenë subjekt i urdhrit të ngrirjes.</p> | <p>activities including terrorism; terrorist financing; involved in activities of a terrorist group or in committing a terrorist act or is associated with proliferation of weapons of mass destruction. The proposal shall also contain detailed information regarding the assets that may be subject to a freezing order.</p> | <p>uključuju terorizam; finansiranje terorizma; uključeno u aktivnosti terorističke grupe ili u izvršavanju terorističkog akta ili je u vezi sa širenjem oružja za masovno uništenje. Predlog takođe treba da sadrži detaljne informacije o imovini koja može biti predmet naloga za zamrzavanje.</p> |
| <p>3. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme ndërmerr hapat e nevojshëm për të marrë informata lidhur me veprimet e shtetit të huaj në përgjigje të kërkesës së bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p> | <p>3. The ministry responsible for foreign affairs shall undertake necessary steps in order to obtain information regarding the actions of the foreign country in response to the request filed according to the paragraph 1 of this Article.</p> | <p>3. Ministarstvo nadležno za inostrane poslove, preuzima potrebne korake da bi dobilo informacije u vezi sa radnjama strane države kao odgovor na podneti zahtev u skladu sa stavom 1. ovog člana.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 9 Listimi sipas kërkesës së shtetit të huaj</p> | <p style="text-align: center;">Article 9 Listing according to the request of a foreign country</p> | <p style="text-align: center;">Član 9 Listiranje na zahtev strane države</p> |
| <p>1. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme, kërkesën e pranuar nga shteti i huaj për përfshirjen e një personi të përcaktuar në listën vendore e dërgon tek Qeveria pa vonesë.</p> | <p>1. The request of a foreign country for inclusion of a designated person to the local list shall be sent to the Government by the competent Ministry of Foreign Affairs, without any delay.</p> | <p>1. Ministarstvo nadležno za inostrane poslove, zahtev strane zemlje za uključivanje označenog lica u domaćoj listi dostavlja Vladi bez odlaganja.</p> |
| <p>2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për personin fizik apo juridik i cili propozohet të përfshihet në listën vendore, përshkrimin e rrethanave me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin në dispozicion që konfirmojnë dyshimin e arsyeshëm dhe lidhjen me Republikën e Kosovës, dhe të dhëna mbi fondet dhe/ose pasuritë që mund të jenë subjekt i urdhrit për ngrirje. Nëse informacionet e tilla nuk shoqërojnë kërkesën, Qeveria kërkon nga ministria përgjegjëse për</p> | <p>2. The request mentioned under paragraph 1 of this Article may contain data on the natural or legal person proposed to be included in the national list; the description of circumstances with the entire available evidence and documentation confirming the reasonable suspicion and the connection with the Republic of Kosovo, and the data on funds and/or assets that may be subject to the freezing order. If such information is not attached to the request, the Government shall request from the</p> | <p>2. Pomenuti zahtev iz stava 1. ovog člana može sadržati podatke o fizičkom ili pravnom licu koje se predlaže da se uključi u domaćoj listi, opis okolnosti sa svim raspoloživim dokazima i dokumentacijom koja potvrđuje opravdanu sumnju i povezanost sa Republikom Kosovo, i podatke o fondovima i/ili imovini koja mogu biti predmet naloga za zamrzavanje. Ako takve informacije ne prate zahtev, Vlada može zatražiti od Ministarstva odgovornog za inostrane poslove da zatraži od strane države</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>punë të jashtme që të kërkojë nga shteti i huaj sigurimin dhe dërgimin e këtyre informacioneve dhe materialeve.</p> <p>3. Pas shqyrtimit të kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni, Qeveria do të shqyrtojë kërkesën dhe bazuar në dyshimin e arsyeshëm se një person është apo ka qenë i angazhuar në aktivitete që përfshijnë terrorizmin; financimin e terrorizmit; i përfshirë në aktivitetet e një grupi terrorist ose në kryerjen e një akti terrorist apo ka lidhje me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, pa vonesë merr vendim lidhur me propozimin për përfshirjen e personit në listën e personave të përcaktuar sipas nenit 6 të këtij ligji.</p> <p>4. Ministria përgjegjëse për punë të jashtme njofton pa vonesë shtetin e huaj kërkuar për përfshirjen apo jo të personit në listën e personave të përcaktuar.</p> | <p>competent Ministry of Foreign Affairs to request from the foreign state the provision and delivery of this information and materials.</p> <p>3. After reviewing the request according to paragraph 1 of this Article, the Government shall examine the request and based on the reasonable suspicion that a person is or was involved in activities including terrorism; terrorist financing; involved in activities of a terrorist group or in committing a terrorist act or is associated with proliferation of weapons of mass destruction, it shall without any delay decide on the proposal for inclusion of the person in the list mentioned under Article 6 of this Law.</p> <p>4. The Ministry responsible for foreign affairs notifies without delay the requesting foreign state for the inclusion or not of the person in the list of designated persons.</p> | <p>da obezbeđivanje i dostavljanje ovih informacija i materijala.</p> <p>3. Nakon razmatranja zahteva iz stava 1. Ovog člana, Vlada će razmotriti zahtev i na osnovu opravdanu sumnju da jedno lice jeste ili je bilo angažovano u aktivnostima koje uključuju terorizam; finansiranje terorizma; uključen u aktivnosti terorističke grupe ili u izvršenju terorističkog akta ili je u vezi sa širenjem oružja za masovno uništenje, bez odlaganja odlučuje o predlogu za uključivanje lica u listu označenih lica iz člana 6. ovog zakona.</p> <p>4. Ministarstva nadležno za inostrane poslove bez odlaganja obaveštava stranu državu o njenom zahtevu za uključenje lica ili ne u listu označenih osoba.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 10 Njoftimi për personin e përcaktuar</p> | <p style="text-align: center;">Article 10 Notice to the designated person</p> | <p style="text-align: center;">Član 10 Obaveštenje o označenom licu</p> |
| <p>1. Vendimi për përfshirjen në listën e personave të përcaktuar i marrë nga Qeveria sipas nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji i dërgohet personit të përcaktuar, në përputhje me dispozitat e ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.</p> <p>2. Vendimi i Qeverisë për përfshirjen në listën e personave të përcaktuar i marrë sipas nenit 6 dhe nenit 9 të këtij ligji është i ekzekutueshëm menjëherë. Ky vendim publikohet në Gazetën</p> | <p>1. The Decision for inclusion in the list of designated persons taken by the Board in accordance with article 6 and article 9 of this Law shall be submitted to the designated person according to the Law on General Administrative Procedure.</p> <p>2. The Decision of the Government for inclusion in the list of designated persons taken by the Board in accordance with article 6 and article 9 of this Law shall be immediately</p> | <p>1. Odluka o uključivanju u listu označenih lica, koju je donela Vlada u skladu sa članom 6. i članom 9. ovog zakona dostavlja se označenom licu, u skladu sa odredbama relevantnog Zakona o opštem upravnom postupku.</p> <p>2. Odluka Vlade o uključivanju u listu označenih lica, koju je doneo Odbor u skladu sa članom 6. i članom 9. ovog zakona mora se odmah izvršiti. Ova odluka se objavljuje u</p> |

| | | |
|---|---|--|
